

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                       |
|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Akuzohet se gënjeu FBI-në përpara se të qëllonte një venezuelian në Minneapolis, agjenti i ICE-së deklarohet i pafajshëm                                                                                                                              |
| ADRESA  | <a href="https://www.gazetatema.net/bota/akuzohet-se-genjeu-fbi-ne-perpara-se-te-qellonte-nje-venezuelian-ne-minneap-i587005">https://www.gazetatema.net/bota/akuzohet-se-genjeu-fbi-ne-perpara-se-te-qellonte-nje-venezuelian-ne-minneap-i587005</a> |
| BURIMI  | gazetatema.net                                                                                                                                                                                                                                        |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                                |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 19 shtator 2026, 06:54:15 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 07:45:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 6312805c358d5157e4516d40a3897e7ba28c93e27ee6d2cca929f84dd62f18b3 |
| TEKSTI     | b9c63f5e7ac62146f5daf7164b07c61ee405b263b402a6f3640425c037131e57 |
| PAMJA      | e460b431ad71ded763069752fbee5a074b26426231021e581b1a6518eedb86e2 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                                                                                    |
|---------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | ecf3491889d61fed5d7f58263a4ffa1d0965d0a77805d39a51fb1f20fb35ea3d                                                                                                   |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                                                                                                  |
| RRËNJA MERKLE | —                                                                                                                                                                  |
| ANKORIMI      | nuk është ankoruar ende<br><i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ecf3491889d61fed5d7f58263a4ffa1d0965d0a77805d39a51fb1f20fb35ea3d>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 [English](#)

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 [English](#)



le "Prania Besnike", zbardhen raportimet nga qarqet/ Qindra ankesa te mbledhura. Rama: Procesi duhet te vijoje sipas objektivaveNdahet nga jeta Sandro Mazzola, ikona e fundit

## Akuzohet se gënjeu FBI-në përpara se të qëllonte një venezuelian në Minneapolis, agjenti i ICE-së deklarohet i pafajshëm



19 Shtator 2026, 09:45Bota TEMA



Një agjent i U.S. Immigration and Customs Enforcement (ICE), Cristian Castro, u deklarua sot i pafajshëm ndaj akuzave federale se kishte gënjyer hetuesit e FBI-së për rrethanat në të cilat qëlloi në këmbë një 24-vjeçar venezuelian në Minneapolis. Castro, 52 vjeç, është vendosur në pushim të papaguar nga detyra dhe është agjenti i parë federal i ndjekur penalisht në nivel federal për një krim të lidhur me Operacionin Metro Surge, gjatë të cilit mijëra forca të armatosura dhe të maskuara u dislokuan në qytete të Minesotës në kuadër të fushatës së administratës së Presidentit Donald Trump për deportime.

Prokurorët federalë pretendojnë se Castro u tha hetuesve se Julio Sosa-Celis dhe persona të tjerë e kishin sulmuar me një fshesë dhe një lopatë bore, duke e detyruar të hapte zjarr. Por autoritetet e kundërshtojnë këtë version. Sipas Prokurores së Qarkut Hennepin, Mary Moriarty, pamjet e kamerave të sigurisë tregojnë se Castro ishte në këmbë dhe qëlloi nga një distancë e afërt përmes derës së hapur të banesës së Sosa-Celis, duke e plagosur të riun në këmbë. "Z. Castro shpiku një histori për të justifikuar të shtënat në derën e një shtëpie ku kishte shumë njerëz në atë kohë", tha Moriarty, duke shtuar se plumbi përfundoi në murin e një dhome fëmijësh.

Castro përballet gjithashtu me akuza shtetërore në Qarkun Hennepin për sulm me armë zjarri dhe kallëzim të rremë të një krimi. Autoritetet e Minesotës kanë kërkuar që prej majit të kaluar kthimin e tij nga Teksasi, ku banon, për t'u përballur me procesin gjyqësor. Castro kaloi 90 ditë në një burg të Teksasit pasi Guvernatori republikan Greg Abbott refuzoi të nënshkruante kërkesën për ekstradimin e tij nga Minesota, e drejtuar nga Guvernatori demokrat Tim Walz.

Pak ditë pas lirim të tij këtë muaj, Castro u arrestua sërish, këtë herë për gjashtë akuza për dëshmi të rreme. Nëse shpallet fajtor, ai mund të përballet me deri në gjashtë vjet burg.

Pas të shtënave të 14 janarit, Castro dëshmoi se kishte qëlluar Sosa-Celis, një shpërndarës venezuelian, pasi ai dhe një tjetër person e kishin sulmuar dhe ishin përleshur me të. Ky version u përsërit më vonë edhe nga ish-Sekretarja e Sigurisë Kombëtare, Christy Noem, dhe zyrtarë të tjerë të administratës Trump. Megjithatë, sipas autoriteteve lokale, pamjet e kamerave të sigurisë nuk e mbështetën këtë version.

Pas publikimit të pamjeve, prokurorët hoqën dorë nga çështja kundër Sosa-Celis. Ndërkohë, zyra e Prokurores së Qarkut Hennepin, Mary Moriarty, vijon

hetimet ndaj agentëve të ICE-së të përfshirë në të shtënat që rezultuan me vdekjen e Renee Goode dhe Alex Petry, të dy shtetas amerikanë, në janar.

 Lini një Përgjigje

Koment \*

Emër \*

POSTOJE KOMENTIN

[Marrëveshje historike për Groenlandën, SHBA zgjeron praninë ushtarake pa ndryshuar sovranitetin danez](#)

[Trump përjashton CNN, Politico dhe MsNow nga Shtëpia e Bardhë: Përhapin lajme të rreme!](#)

08:05 Bota

Raporti i rremë i IA-së për pak sa nuk nisi luftë mes SHBA-së dhe Kinës, CNN: Operacioni u anulua në momentin e fundit

07:56 Bota

Zgjedhjet e së dielës në Berlin dhe Mecklenburg! Një provë e re për Merzin pas humbjes së rëndë në Saksoni

07:43 Bota / 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.